

Statuti
I Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar
FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Sot, më 03 Janar 2022, Ortaket e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Falcon Distribution” shpk vendosin miratimin e Statutit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Falcon Distribution” shpk si më poshtë:

Neni 1:
Ortakët e Shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK. do të jetë shoqëri dhe. Ortaket e shoqërisë janë :

- Z. **Artur Zenelaj**, i biri i **Vladimirit** dhe **Suzanes**, shtetas Shqiptar, lindur më 30 korrik 1975, në **Vlore**, Shqiperi, mbajtës i Kartes se Identitetit me nr. Personal H50730132T, banues në adresën: **Rruga Siri kodra njesia nr 8 AP 2 SHK 2**, me nr. Telefoni 00355697088100
- Z. **Maringlen Zenelaj**, i biri i **Vladimirit** dhe **Suzanes**, shtetas Shqiptar, lindur më 27 mars 1981, në **Vlore**, Shqiperi, mbajtës i Kartes se Identitetit me nr. Personal I10327100V, banues në adresën: **Rruga Siri kodra njesia nr 8 AP 2 SHK 6**, me nr. Telefoni 00355692073100
-
-

Neni 2
Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3
Forma ligjore

Ortaket bien dakord që FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK. është krijuar dhe do të vazhdojë aktivitetin e saj në bazë të këtij Statuti në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me dispozitat e Pjesës IV të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



**Neni 4:
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- **Shitje me shumice e pakice, import-export i artikujve ene guzhine, artikuj te ndryshem industrial dhe shtepiak, elektroshtepiak, aksesori, transport, artikuj te ndryshem per bare restorante dhe hotele si dhe artikuj te ndryshem, shitje online e.t.j**

**Neni 5:
Kohëzgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin që ka për objekt për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.

**Neni 6:
Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Vlore-Skele nr 256 kati 3 Vlore Shqipëri. Ortaket e shoqërisë, mund të vendosin, të ndryshojne selinë, të hapin zyra përfaqësie, degë, të krijojne filiale dhe/ose të realizojne çdo lloj pjesëmarrje ne shoqëri te tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Kreu II
Kapitali**

**Neni 7
Kapitali themeltar**

Numri i përgjithshëm i kuotave në shoqëri është 1 (një).

Kapitali i shoqërisë është 1.000.000 (Njemilion) Lekë. Pjesëmarrja e Ortakeve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me zotërimin e tij të përqindjes në shoqëri si më poshtë:

1. Ortaku **Artur Zenelaj**: Zotërues i 1 (një) kuote/pjese me vlerë të përgjithshme 510.000 (pesëqind e dhjete mijë) lekë që përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë.
2. Ortaku **Maringlen Zenelaj**: Zotërues i 1 (një) kuote/pjese me vlerë të përgjithshme 490.000 (katerqind e nentdhjete mijë) lekë që përbën 49 % të kapitalit të shoqërisë

Kuota dhe përqindja, ose një pjesë e tyre, në shoqëri, është lirisht e transferueshme në çfarëdo forme tjetërsimi.

Përgjegjësia e ortakeve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

Në rastin e trashëgimisë, kuotat dhe pjesët e kapitalit i kalojnë lirisht trashëgimtarëve të ligjshëm të ortakeve.



Neni 8:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit, ose ortakeve të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet me vendim të ortakeve të shoqërisë, te cilet marrin vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 9
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga ortakët e shoqërisë, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10
Organi Vendimmarrës

Ortakët e Shoqërisë janë organi më i lartë dhe i vetëm, vendimmarrës i shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë janë organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Ortakët e Shoqërisë janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) transferimin dhe/ose tjetërsimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të shoqërisë.
- m) marrjen dhe dhënien e kredive ose të huave për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- o) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët e shoqërisë . Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistrë të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 11

Administrimi

(1) Ortakët e Shoqërisë emërojnë një ose më shumë administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administrator i shoqërisë emërohet:

- **Z. Artur ZENELAJ**, i biri i **Vladimirit** dhe **Suzanes** , shtetas Shqiptar, lindur më 30 korrik 1975, në **Vlore** , Shqiperi , mbajtës i Kartes se Identitetit me nr. Personal H50730132T, banues në adresën: **Rruga Siri Kodra Njesia nr 8** , me nr. telefoni 00355697088100 dhe email a.zenelaj@falcondistribution.al

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;



- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të vetëm për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojë përpara Ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
- h) të zbatojë vendimet e marra nga Ortakut i Vetëm i Shoqërisë.
- i) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori do të përfitojë një shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

Administratori ka të drejtë të lidhë kontrata pune me individë të ndryshëm, për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë sipas objektit të saj. Këto kontrata pune do të rregullohen në bazë të legjislacionit përkatës të punës dhe të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Administratori i paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit, apo të tjera shpenzime që kryhen në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 13 **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- b) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- c) jep kredi ose hua në emër të shoqërisë.

Administratori i Vetëm, me miratimin e Ortakeve të shoqërisë ka të drejtë t'u delegojë me prokurë një pjese të kompetencave të tij, personave të tretë të caktuar prej tij, por jo më shumë se për një periudhë 6 mujore. Administratori i Vetëm nuk mund të delegojë asnjërin prej detyrimeve të cilat ia ngarkon ligji atij për ushtrim.

Neni 14 **Shpërndarja e Fitimit/Dividendi**

Në fund të vitit financiar, Ortaket e shoqërisë kane të drejtë të ndajë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, Ortaket e Shoqërisë vendosin shpërndarjen e dividendit në përputhje me të drejtat e tij në shoqëri.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertët**

Neni 15 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 16 **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut.



Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzoje ne kohe ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

Neni 17 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në Statutin e shoqërisë;
- b) me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18 **Riorganizimi i shoqërisë. Bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Ortaku të Vetëm të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 19 **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



Neni 20

Ndryshimet

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e te zëvendësohet me një statut te ri vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.


Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K U
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK.

Artur Zenelaj



O R T A K U
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FALCON DISTRIBUTION CASH & CARRY SHPK.

Maringlen Zenelaj

